



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

01 Numër: 52/2018

Data: 23.05.2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 44.1, 42 dhe nenit 54.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010,

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 6^{-të} e rregullte e Legjislacionit të VI^{-të} të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **30.05.2018**, e **Mërkurë**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për sanimin e gjendjes aktuale e cila mbretëron në NLP "Stacioni i Autobusëve" në Istog
4. Raporti i punës së Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti " në Istog për vitin 2017,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.09/2017 të dt.31.01.2017.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për plotësimin e vendimit 01Nr.69/2017 të dt.05.05.2017,

KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL

Z. QAUSH BALAJ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 5^{-të} e Legjislacionit të VI^{-të} të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 30.03.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 2. Enver Rugova, LDK; | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 3. Zenel Shatri, LDK; | 18. Arben Kabashi, PDK; |
| 4. Besa Ferati, LDK; | 19. Lulzim Shoshi, PDK; |
| 5. Naim Behlulaj, LDK; | 20. Ajshe Metaj, PDK; |
| 6. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 21. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 7. Haki Podrimaj, LDK; | 22. Agron Avdijaj, VV; |
| 8. Selajdin Bytyqi, LDK; | 23. Lavdiqe Bujupaj, VV; |
| 9. Hajrush Shoshi, LDK; | 24. Arif Elshani, AE; |
| 10. Valbona Demaj, LDK; | 25. Radoš Repanović, SL; |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK; | 26. Radenko Belošević, RB; |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 27. Slaviša Maliković, SM. |
| 13. Negjmedin Balaj, AAK; | |
| 14. Muhamet Ukaj, AAK; | |
| 15. Eliot Kukiqi, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Nënkryetari i Komunës z. Lulzim Blakaj, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d d i t e

1. Dhenja e betimit të anëtareve të Kuvendit të Komunal nga radhët e LDK-së dhe PDK-së,
2. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - plotësim ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, Nr. 01/2017;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018;
6. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë, Janar-Prill 2018;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë;
8. Marrja e vendimit për formimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Raporti të punës së Ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve “ për periudhën 1 vjeçare , Prill 2017-Mars 2018.
10. Marrja e Vendimit për themelimin e inkubatorit të biznesit.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron rrethe pikës së parë të rendit të ditës e cila hiqet nga rendi i ditës për shkak se KQZ nuk ka kthyer ndonjë konfirmim për anëtarët e rijnë.

Pyete anëtarët e Kuvendit nëse dikush ka ndonjë diskutim apo pyetje rreth rendit të ditës. Fjalën ia kalon Nënkryetarit të Komunës z. Lulzim Blakaj.

Nënkryetarit të Komunës - përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që të hy si pikë e rendit të ditës Rialokimi i mjeteve nga nënprogrami buxhetor të Arsimit shkollës së mesmes në nënprogramin buxhetor të programit të arsimit fillor, Kuvendi duhet të marr një vendim për këtë alokim.

Arben Kabashi, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete kryesuesin si do t’ia bëjmë këtij mandati a do ta bëjmë ndonjë kontratë me ndonjë medium ti përcjelle mbledhjet apo si do të ja bëjmë.

Nënkryetari i Komunës – njofton të gjithë anëtarët e Kuvendit se ende jemi duke e negociuar ofertën pasi që është shumë e lartë por besoj se me ndonjë medium do të arrimi marrëveshje dhe do ta angazhojmë.

Kryesuesi - hedh në votim propozimin e Nënkryetarit të Komunës: Rialokimi i mjeteve nga nënprogrami buxhetor të Arsimit shkollës së mesmes në nënprogramin buxhetor të programit të arsimit fillor .

Kush është që të shtohet kjo pikë e rendit të ditës

Kuvendi i Komunës në mënyra anonime vendosi:

Miratohet të hy kjo pikë në rend dite .

Hedhë në miratim rendin e ditës
Kuvendi i Komunës në mënyra anonime vendosi:
Miratohet rendi i ditës.

Shqyrtimi i pikës 1.

Në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Shqyrtimi i pikës 2.

U shqyrtuan procesverbalet nga mbledhja e kaluar e kuvendit (të gjithë anëtarëve të kuvendit iu është shpërndarë procesverbali nga mbledhja e kaluar dhe e njëjta gjendet në dosje: “shembulli 3”). Fjalën e kërkon z. Arif Elshani.

Arif Elshani, IQ - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyet Kryesuesin e Kuvendit a është e obliguar që në mbledhjen e kuvendit të marr pjesë edhe Kryetari i Komunës.

Pasi që nuk pati vërejtje në procesverbal, Kuvendi i Komunës vendosi:
Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje
Nga mbledhja largohet Arif Elshani

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi – vazhdojmë me piken e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - plotësim ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, Nr. 01/2017, kemi pasur ko që ta analizojmë këtë rregullore kemi pasur dëgjimin publik.

Nënkryetari i Komunës – thekson së është një Rregullore e një rëndësie të veçante për komunën,

Hysni Maxharraj, Drejtor i drejtoriatit për Buxhet dhe Financa - përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron të gjitha pikat.

Lavdie Bujupi, VV - përshëndet të gjithë të pranishmit, thekson se materialin për këtë rregullore e kanë pasur me kohë dhe verën disa ndryshime të lehta mirëpo të arsyeshme ndërsa diçka që e ia ka tërhequr vëmendjen është tek ngarkesa e lajmërimit të rasteve të te vdekurve lajmërimi i mëvonshëm taksa nga 5 euro në 50 euro duket si ndryshim i madhe. Pyet drejtorin a është kjo në udhëzim apo ligj dhe pse gjithë ky ndryshim.

Nënkryetari i Komunës – i përgjigjet se ky dënim është i përcaktuar me ligj dhe ne jemi të obliguar që ta zbatojmë.

Lavdiye Bujupi, VV – a është me udhëzim administrativ?

Nënkryetari i Komunës – përgjigjet është e përcaktuar me ligj.

Arben Kabashi, PDK – ka disa vërejtje dhe sugjerime, a është ko e njëjta rregullore si për çdo vite, ku ka pasur gjoba pa emërtime aty ka rritje të te hyrave siç është rasti tek neni 2 pika 1.2 regjistrimi i vonuar i lindjes pas një muaji nga 5 në 20 euro, po ashtu tek i njëjti nen neni ka ngritje të taksave deri në nivelin e papërballueshëm të qytetarit të Istogut. Neni 3 pika 5.5 certifikatat shëndetësorë për certifikim dhe shkollim kjo është taks e re 10 euro.

Pyet se a ka bërë dikush analizë për këto ndryshime dhe a është mbledhur far grupi i eksperteve për ta hartuar këtë Rregullore apo ka vazhduar njëjtë. Në rastin e par 1.1 kishte qenë me mirë që niveli komunal me organizuar fushat vetëdisuese për familjet që jetojnë në Istog se fëmijët duhet të regjistrohen po ditën e parë të lindjes. A ka kërkuar vetë komuna këto ngritje apo ka pasur sugjerime nga qytetarët me i ngrit këto taksa beson që kjo nuk ka ndodhur. Të neni 3 pika 5. 5 10 euro për dy certifikata ku prekën drejtë mirëqenien e para me e nxjerrë një certifikatë shëndetësorë pse duhet me nxjerr dhe pse ndodhë kjo dhe e dyta për edukim këshillim. Pyet komuna a ka interesa për një qytetar të kujdeset për aspektin e tij shëndetësor dhe avancimin e tij në aspektin e shkollimit avancimin akademik apo përmes këtyre taksave në të zgjedhurit e këtij vendi krijojmë politika demotivuese për ta. Shqetësimi i tij tjetër është caktimi i taksave të pa definuar qëllimi i tyre është me rastin e vërtetimit dhe motivimi i tyre, vërtetime dhe pëlqime të ndryshme 10 euro.

Të ndahen rastet kemi udhëtimet Istog- Shkup ose Istog- Tiran taksa 150 euro është zbrit në 100 euro por kisha dashur me bë kategorizimin e këtyre p.sh qytetarët e rëndomte por edhe në 80 me zbrit nuk ka problem, sepse këtu po i bëjmë keqpërdorim karburantit. Rastet sociale të hiqen krejt nga taksat kur të kenë nevoja me i bë këto udhëtime me ambulancë po ashtu familjet e dëshmoreve dhe invalidëve të luftës, po me duket që është e ngarkuar pak me taksa kjo rregullore pak një papërgjegjësie.

Nënkryetari i Komunës - thotë se për shkak të stimulimit të bizneseve të reja të gjitha ngarkesat për biznese janë hekur jemi një ndër Komunitatet e vetme në Kosovë që nuk e ngarkojë biznesin me asnjë taksa në tersi këto taksa janë hequr. Ndërsa të regjistrimi i vonuar siç e çeku edhe me herët kjo është taksa ligjore për të cilën detyrohem me ligj që ta kemi. Sa i përket taksave nga drejtoritë për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit këto janë të gjitha të përcaktuara me udhëzim administrativ janë shërbime kadastrale dhe si të tilla ne si Komunë nuk kemi të drejtë dhe mundësi që t'i ndryshojmë.

Thekson që për këtë rregullore është formuar komisioni të cilët kanë punuar dhe kanë zbatuar të gjitha procedurat duke i paraparë edhe dëgjimin publik me qytetar ka qenë dëgjim publik 15 ditësh ka pasur prezent qytetar dhe kanë bërë disa vërejtje të cilat janë shqyrtuar dhe në Komitetin për Politikë e Financa dhe si të tilla nuk janë marrë si të bazuara, janë edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa sa i përket tarifës për këto ambulanca këtë tarifa janë të përcaktuara jo për raste emergjente këto janë raste të cilat shkojnë sipas raportit të mjekut por jo emergjente për shkak të gjendjes së pacientëve, të cilin transport jua mundësojmë ne, rastet sociale gjithnjë janë të liruar nga pagesat jo vetëm të ambulancat po edhe shërbime tjera. Të këto 100 euro hynë karburanti për ambulanca dhe një mëditje për shoferin i cili vizitë. Tek zgjatja e orarit të punës për lokalet gjatë natës sezonin e verës apo për pijet alkoolike kjo është me udhëzim

administrativ dhe me ligj e përcaktuar, shumë Komuna e kanë Rregulloren e veçante për rregullimin e orarit të bizneseve ne ende nuk e kemi një Rregullore të tillë. Thotë së Rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba nuk është rregullore e cila do ta ngarkojë buxhetin e qytetarëve të Komunës së Istogut.

Mujë Osmanaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi - përshëndet të gjithë të pranishmit, thotë se nuk ka marr pjesë na takimin apo në komision për këtë rregullore sepse nuk ka qenë i ftuar, beson që takimet tjera të jetë i ftuar të marr pjesë. Thotë se niveli i Shëndetësisë është primar, sekondar dhe traciari të gjitha rastet që në Istog nuk kryhen i dërgojmë në Pejë niveli sekondar ku aty epet një ndihmë e madhe por ka raste që i dërgojmë në Prishtinë ndërsa Prishtina është adresimi jonë i fundit që ish dashur t'i dërgojnë pacientët për raste emergjente ndërsa Prishtina vendos për më tutje. Ketë e merr si vullte nëse ne si shëndetësi dëshirojmë të kryejnë një punë ta dërgojmë një pacient me vetëdëshir në Tiranë apo Shkup kudo tjetër.

Nënkryetari i Komunës - e mbështet drejtorin e Shëndetësisë por ne po e përcaktojmë transportin e për persona të cilët kanë nevojë deri atje me u transportua me ambulanca.

Arben Kabashi, PDK - thekson që pasi Nënkryetari tha që nuk ka ngritje të taksave në bazë të ligjit, ligji nuk e thotë regjistrimi i vonuar i lindjes pas një muaji nga 5 euro në 20 euro me u ngrit ose neni 3 certifikatat për edukim dhe këshillim është taksa e re 10 euro, kemi ngritje të taksave.

Nënkryetari i Komunës - ligji e përcakton decidivish kemi këtu edhe zyrtare ligjore e cila bashke me një ekip të profesioneve që i përkasin natyrës së kësaj rregullore janë punuar në harmonizimin e ligjeve me Rregulloren në fjalë. Ka vërtetime të ndryshme në shërbime publike të cilat duhet të paguhen.

Agron Avdiaj, VV - përshëndet të gjithë të pranishmit, thotë që një pjesë të shqetësimeve e ka prekur edhe Arbeni që nuk dëshiron të i përsëritet mirë po propozon sa i përket taksave të reja të cilat parashihen me ligj ashtu siç thotë Nënkryetari. Ndryshimi prej 5 euro në 50 euro të rastet e vdekjes është në rregull ligjore mirë po ju duhet të dini që keni me u ballafaquar me rastet konkrete me familjarët që vinë pastaj edhe dënimet edhe konfliktet që keni me i pasur për këtë arsye sugjeron Komunën që ta bëjë një promovim të këtyre edhe pse i kanë ngritur taksat me dal në Radio me i njoftuar qytetarët paraprakisht pse kanë ndodhur këto ngritje pse një konflikt shumë i madh po ndodhë kur qytetarët janë të pa njoftuar për vendimet që po merren në Kuvend.

Nënkryetari i Komunës - ne i kemi ftuar të gjithë qytetare 15 ditë kanë qenë njoftimet edhe në Radio edhe në ueb faqen e komunës edhe tek shpalljet njoftimi për dëgjim publik me qytetarët për këtë Rregullore që të janë pjesëmarrës aktiv që me vërejtjet dhe sugjerimet e tyre të ndikojnë. Ligji është i miratuar në 2011që në me këto tarifa nuk i kemi aplikuar dhe kemi vërejtje të vazhdueshme nga agjensioni i regjistrimit civil Pse nuk aplikohet kjo.

Naim Imeraj, AAK - përshëndet të gjithë të pranishmit, sugjeron ekzekutivin që paraprakisht ta ketë parasysh që duhet çdo propozim që vjen prej tij ta ketë një elaborim me të mirë, na ka ndodhur përpara që kjo rregullore të na kthehet nga nivelet e ministrisë përkatëse për shkak të një pozicioni që e kemi kaluar si procedura por i kemi humbur kohë vetës dhe zbatimit të sajë, është pak goditëse kur nga 5 euro ngritët në 50 menjëherë, duhet të jemi të vetëdijshëm që fillimi i një jetë dhe mbarimi i një jetë është një periudhë e cila ka lenë gjurmë edhe në familje duhet të jemi të vetëdijshëm që me qenë të përgjegjshme edhe ndaj atyre dy periudhave edhe kur regjistrojmë fëmijë e porsalindur edhe kur ti çregjistrojmë ata të cilët kanë lënë gjurmë në jetën tonë nuk dua ta arsyetoj mirëpo qysh në fillim është dashur të tregohet a është hapësira jonë ku kemi marr ne vendim edhe ku kemi caktimit ligjore se paku ta kemi informacionin, falënderon për kontributin gjë për çka edhe jemi në këtu për sqarim gjërash. Thekson se të te hyrat vetanake kemi një shumë të konsiderueshme të pa përfillshmë, vjen në shprehje se a po e zbatojmë ne këtë rregullore apo vetëm po e zbatojmë me ngritjen e duarve miratimin e sajë po e përfundojë një periudhë një vjeçare këtu besoj që ekzekutivi ka për përgjegjësi me bërë të mundurën që pozicionet të cilat i dimë shumë mirë posaçërisht në ato pozicione që kanë të bëjnë me pronat publike të ngritën në nivelet e inkasomi që po me duket që po kalojmë në periudha që njerëzit po thonë hajet së bane.

Zenel Shatri, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, të shëndetësia rastet që duhet të dërgohen jashtë shtetit me duket se janë edhe me ligj të përcaktuar, dhe janë të domosdoshme për tretman të domosdoshëm që nuk kryhet me nivelin tregial të Kosovës, kështu që Komuna ka obligim me e siguruar transportin, sepse pajisjet që i ka ambulanca nuk mund ti ketë as një automjet tjetër, mendon që ato tarifa nuk janë shumë të mëdha.

Haki Podrimaj, LDK - përshëndet të gjithë pranishmit, propozonë që neni 5 pika 5 shuma qerifikatat shendetsore për edukim dhe këshillim prej 10 euro në 5 Euro, neni 3 pika 1 nga 10 Euro në 20 Euro automjetet me 5 ulëse.

Hajrush Shoshi, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, të taksa për lindje dhe vdekje a ka mundësi pasi që është edhe me ligj të bëhet një pauzë prej tre muajve të sensibilizohet opinionin të njoftohen që ka një pauzë prej tre muajsh që ti vin në shërbimin civil dhe ti kryejnë këto obligime.

Nënkryetari i Komunës - thekson së taksa prej 10 Euro për certifikatat shëndetësore për edukim dhe këshillim është me udhëzim nga shëndetësia dhe nëse e zbresim këtë taksa Ministria linjë na kthen rregulloren në shqyrtim.

Enver Rugova, Drejtor i Shërbimeve Publike - thotë që e përkrahë propozimin e z. Haki pasi që ka qenë disa herë temë taksitë ilegale nuk mundet me kanë gjithkush taksist ju lutem në po pretendojmë me zhvilluar turizmin, ekonomin etj, nuk ka pa lejë pa procedura të jetë taksi me u rrezikuar jeta e qytetarit edhe rrezikohet çështja e trafikut urban të komunës së Istogut, duhet me u klasifikuar kush mund të jetë taksitë.

Naim Behlulin, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyet të neni 8 pika 2.1 lejë për prerjen e asfaltit për një metër katror 50 Euro dhe për trotuare rrugë me zhavorr

25 Euro a keni marr vendim a ka ndonjë raport a keni dënuar dikën pasi që ka mjaftë rrugë të prera dhe askush nuk merr përgjegjësi.

Nënkryetari i Komunës - përgjigjet, kjo është taksë që përfshihet ekipi i Komunës për me e bërë mbikëqyrjen dhe e paguajnë por pa lejë mesa e di askush nuk guxon me pre rrugë

Ajshe Metaj, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, thotë se edhe me herët u përmend se është dashur kjo që të njoftohen qytetarët për ndryshimet e kësaj rregulloreje komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba, pyete a ka qenë e hartuar kjo rregullore para dëgjimit publik në mënyre që këto ndryshime me ju treguar qytetarëve për këto ngritje të taksave a ka pasur reagim nga qytetarët a është prezantuar kjo ngritje e taksave.

Nënkryetari i Komunës - thotë, në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kur e kemi marr vendimin për shpalljen në dëgjim publik të kësaj rregullore si e tillë ka qenë edhe rregullorja me të gjitha këto taksa. Lexon propozimet dhe sugjerimet e qytetarëve.

Kryesuesi - hedh në votim propozimin e z. Haki që taksa për taksë për automjete mi 5 ulëse të ngritet nga 10 Euro në 20 kush është për 13 për, dhe 12 abstenim, Kuvendi vendos:
Miratohet me shumicë votash

Hedhë në miratim piken e rendit të ditës:

Kuvendi i Komunës në mënyra unanime vendosi:

Me 20 vota për 6 abstenime

Miratohet Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, 2018.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi – propozon që të vazhdohet me piken e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018

Hysni Maxharraj, Drejtor i drejtoriatit për Buxhet dhe Financa – prezanton dhe sqaron, Propozim Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018.

Arben Kabashi, PDK - pyet si është bërë përzgjedhja e projekteve të reja, a ka pasur projekte me emergjente në fshatra si dhe në qendrën urbane a e kini bërë këtë krahasim se cila ka qenë me primare që me u nisur tani.

Hysni Maxharraj, Drejtor i drejtoriatit për Buxhet dhe Financa - thotë se e çeku që janë vetëm 246, 997.33 Euro për kapitale projekti i parë asfaltimi i rrugës "Selmon Tahir Sylja" Në fshatin Lluga nëse ju kujtohet e kam sqaruar pse është

projekt me bashke financim. Po ashtu edhe asfaltimi i rrugës "Arif Halili" në fshatin Muzhevina, edhe ky është projekt me bashkë financim. Të projekti me gypa të kanalizimit është kod që ka qenë i planifikuar edhe në buxhetin e vitit të kaluar, të kanalizimi Cerrcë Lubozhë në lagje të Kadajt, Haskaj, Osmanaj ka qenë i propozuar në rishikim të buxhetit dhe është bartur, i nijeti është kanalizimi në lagjen Ibrahimaj fshati Zhakovë, Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Kamenicë ka qene në listën e të hyrave në vitin 2017 po për shkak së nuk është realizuar buxheti ka mbetur dhe besojmë që do ta realizojmë këtë vitë. Rregullimi i varrezave të reja në fshatin Lubozhdë ka qenë i vitit të kaluar barten mjetet e njëjta në këtë vitet. Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt, rregullimi i përroit vërshuese në fshatin Baicë të bujqësia është i vitit të kaluar, dhe i ri të arsimit në kemi aprovuar ridestitimim e mjeteve në vlerë prej 26mijë Euro nuk është aprovuar nga niveli qendrorë dhe këto dyja projekte i kemi përsëritur që të bëhet bartja dhe të realizohet, kemi dyshemetë në shkollën fillore Fanë Noli që duhet të ndërrohen.

Arben Kabashi, PDK - thotë se e ka ndërlidhur këtë për shkak të kërkesave dhe nënshkrimeve të qytetarëve vitë pas viti të kërkesave të vazhdueshme.

Hysni Maxharraj, Drejtor i drejtoriatit për Buxhet dhe Financa - prioritet kanë qenë projektet nga të hyrat vetanake dhe transferet tani së shpejti kanë me filluar rishiqimi i buxhetit dhe menjëherë do të filloj edhe planifikimi i buxhetit për vitin e kaluar dhe të gjitha ato projekte që na kanë mbetur pa u futur në lista do të fillojmë me realizojmë atyre projekteve.

Besa Ferati, LDK - përshendet të gjithë të pranishmit, kërkon sqarim kurë është diskutuar në KPF për bustin e Fadil Feratit tani është shtuar fjala konkurse pse?

Hysni Maxharraj, Drejtor i drejtoriatit për Buxhet dhe Financa - sqaron që për hire të anëtareve që është bërë propozim në komitet është folur që zë bëhet konkurs, tani ju vendosni se a do të mbetet konkurs apo të hiqet.

Nënkryetari i Komunës - hiqet fjala konkurs por në kuadër të projekti do të qitet një konkurse.

Naim Imeraj, AAK - sugjeron që të tregohen parimet mbi të cilat bëhet kjo shpërndarje, në kategori ekonomike a mundën me shkua mjetet nga një kategori ekonomike në një kategori ekonomike tjetër duhet me qenë të vetëdijshëm se seancën e kaluar kemi folur për borxhe të pasqyrat i kemi parë borxhet dhe një pjesë e projekteve ka të bëj me mbulimin e burgjeve kishte qenë mirë me qenë të singerta në raport me anëtarët e Kuvendit dhe me treguar cilat borxhe nga viti i kaluar janë duke u mbuluar. Projekti i parë të shpenzimet kapitale është borxh i bartur nga viti i kaluar, furnizimi me gypa të kanalizimit dhe ujësjellësit me 53mijë Euro, buxheti i viti 2018 është zero sa kamë mundur ta vërej a po e mbulojnë. furnizimi me gypa të kanalizimit me çka ka të bëjë. Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt më çka ka të bëjë kurë raportojmë e që secilën herë

kemi me pak rrugë të pa asfaltuara 50 mijë euro me i shtua e 20 mijë janë të parapara me buxhet të viti 2018 po bëhen 70mijë Euro a kemi qikaç rrugë të cilat duhet të mirëmbahen.

Nënkryetari i Komunës - sqaron, gypat e ujësjellësit dhe kanalizimit ka qenë kontrata kornizë gjë që e cila kontratë skadon me përmbushjen e shumës së planifikuar dhe me kalimin e afatit, kjo kontratë si e tillë përfundon, të mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt ka rrugë shumë të cilat nuk janë asfaltuar ende dhe ato duhet të mirëmbahen.

Jemi duke i përmbushur obligimet për 14,470.00 borxh dhe tjerat në kuadër të planifikimit të kontratës kornizë 53 mijë dhe 50 mijë janë përmbushje e këtij obligimi.

Agron Avdiaj, VV - thotë së ndoshta kishte qenë mirë që herëve tjera për në si asamblistë me të ri që jemi e ndoshta që nuk ki qenë të përfshirë në shumicën e këtyre projekteve kurë janë miratuar ndërsa këtu po thuhet bartja nga viti 2016 dhe 2017 siç e ka përdorur projekt i ri 2018 na kishë dhënë mundësia ne me pyetën pse është vonuar apo diçka të tillë.

Radoš Repanović, SL - Rruga në Cërkolez është e pa kalueshme kur do të rregullohet.

Nënkryetar i Komunës - thekson se të gjitha këto projekte të prezantuara këtu i nënshtrohen votimit, jemi të njoftuar për çështjen e rrugës në fshatin Cërkolez, por këto mjete janë të pa mjaftueshëm për ndërtimin e asaj rrugë atje.

Radoš Repanović, SL – ajo rrugë është në fshat brenda, ajo është rrugë malore deri të kisha.

Nënkryetar i Komunës – thotë se e kuptoj për cilën rrugë por sivjetë nuk ka mjetë për asfaltimin e kësaj rrugë.

Kuvendi komunal më 21 vota për, dhe 3 abstenime vendosi:
Që Propozim Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2016, 2017 në vitin 2018
Miraton me shumicë votash.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë, Janar-Prill 2018,

Osmon Sadikaj, Zyrtar Kryesor Financiar – prezantoi dhe sqaron Raportin financiar për tre mujorin e parë, Janar-Prill 2018.

Naim Imeraj, AAK - me keqardhje që nuk e kemi pasur të gjithë materialin, tre mujorshi i parë ka zhvillime me të ngadalshme sepse sa fillojnë të planifikohet buxheti, dhe procedurat e realizimit të projekteve në aspektin e shpenzimeve.

Të të hyrat vetanake është një tënd i mirë dhe në tremujor shator tjerë nëse përcillet ky trend do të jetë inkasimi i të hyrat vetanake ku nxjerr në përqindje 21,5% të kodi 21 dhe At afër 21% duke i përfshirë edhe gjobat në komunikacion dhe nga gjykatat është një rrugëtim i mirë që ne me i krye ato çka varen nga ne, kjo formë e prezantimit po hendikupon pak në atë kuptimin që zyrtari kryesor financiar që me i pa edhe burimet e financimit.

Tatimi në pronë ka lëvizje dhe është 28% dhe jep një shtytje përpara është njëra nga 3 shtyllat që e mbajnë buxhetin në aspektin vëllimore kishte qene mirë që këtë trendët pavarësisht fakti që ka pasur vjelje po nuk e ka përcjellure as në faktin monetar e as inkasimi në nga lejet e ndërtimit, po shihen ndërtimet duket një jo proporcionalitetit në raport me vjeljen. Ka edhe detyrime të vjetra të ndërtuara në raport me këtë vi buxhetore nga të planifikuara 150 mijë janë realizuar 23mijë që janë sikundër 15,6% e që është pak e zbehet shpresoj të këtë përmirësime.

Osmon Sadikaj, Zyrtar Kryesor Financiar - planin detal për vitin 2017 do ta keni komplet me analitikë detale do të jetë në ueb faqe

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka kalojmë ne piken e radhës.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e gjashtë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë;

Nënkryetari i Komunës – prezantoi dhe sqaron i Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë

Kuvendi komunal më 19 vota për, dhe 3 abstenime vendosi:
Që Propozim-Vendimit për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë
Miraton me shumicë votash.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e shtatë të rendit të ditës, Marrja e vendimit për formimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve

Nënkryetari i Komunës- bënë prezantimin dhe sqarimin për formimin e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale, Stacioni i Autobusëve.

Naim Imeraj, AAK - propozon çelësin e këtij komisioni që një anëtar të jetë nga Partia me e madhe dhe anëtar tjetër nga Partia e dytë.

Kryesuesi - kjo është propozuar edhe në KPF.

Radoš Repanović, SL - Propozon që një anëtar të jetë nga lista serbe,

Kryesuesi – lista serbe e ka vetëm një anëtar tjerët janë të pavarur.

Radoš Repanović, SL - ne jemi tani një grup parlamentar.

Arben Kabashi, PDK - thotë së mandatin e kaluar kanë ra dakord opozita dhe e kanë dërguar në këtë komision kandidatin e pavarur Arif Elshani tani e kemi prape të njëjtën rrugë duke e ditur së LDK kanë koalicion atëherë këtu nuk shkruana që në bazë të numrit të asamblistëve ose grupeve parlamentarë që janë në Kuvend me u përcaktuar edhe çelësi po thjeshtë në bazë të koalicionit nëse donë që një nga LDK dhe një nga PDK.

**Kuvendi komunal më 16 vota për , 3 kundër dhe 3 abstenime vendosi:
Që të formohet komisioni i aksionarëve të Ndërmarrjes publike lokale,
Stacioni i Autobusëve, me këtë përbërje Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike,
dhe dy anëtar nga Kuvendi 1 LDK z. Selajdin Bytyqin dhe 1 nga AAK znj. Jehona Haxhiaj.**

Miraton me shumicë votash.

Kryesuesi - lutë anëtaresit ti japin propozimet për këtë komision.

Naim Imeraj, AAK - propozon znj. Jehonë Haxhiaj.

Zenel Shatri, LDK - propozon që emrin do ta japin gjatë javës.

Kryesuesi - po kemi probleme me emrat e Komisionit ju lutem që emrin se afat sa më të Shkurten të na dërgoni emrin, sepse afati për ti dërguar për shqyrtim të ligjshmëria është 7 ditë.

Agron Avdiaj, VV - pyet se këta anëtar a do tu nënshtrohet vitesh së Kuvendit apo jo.

Kryesuesi - jo votës vetëm përbërja ju nënshtrohet por jo kandidatët sepse partitë kanë të drejt të zgjedhin përfaqësuesin e tyre.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e tetë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Raporti të punës së Ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve “ për periudhën 1 vjeçare , Prill 2017-Mars 2018.

Arben Kabashi, PDK - e kamë lexuar raportin, sugjeron kryeshefin ekzekutiv Mentor Vuthaj po ashtu edhe për bordin që të jenë me të kujdesshëm në drejtshkrim sepse është ofendues për anëtarët e Kuvendi kështu, kjo kompani me 126.53,00 Euro borxhe të pa paguara është me mirë të mshellet krejt kjo kompani dhe me shkua në shpi e kam fjalën direkt për krye shefin ekzekutiv Mentorin dhe për bordin që veç sa i ka sjellë dëm kësaj kompanie lokale të bëhet një zgjidhje urgjente, jep këshilla

Të hartohet me urgjencë komplet stafi ekzistuese, të ndryshohet statusi i aksionari kryesor të Stacionit të. Autobusëve p. sh të epet me konfensional statusi publikoi privat apo të formohet një ekip i përkohshëm që ka me menaxher stacionin e Autobusëve ekip me përvojë profesionale jo partiake. Kryesisht të falimentuar bordi pranon kërkesën e një anëtarit të përgjysmoj orarin e punës me vendim të bordit por këtu nuk ka shënime nëse paga ju ka përgjysmuar në raport. Bordi ka kërkuar nga Komuna subvencion për periudhën 3 vjeçare 10 mijë euro dhe është aprovuar vjetë kjo kërkesë për një vite për me i la borxhet e pagave të vitit 2016, pyet a kanë bërë planë financiar para se me bërë kërkesë nga komuna, pse me e ndërruar destinomini e mjeteve me krijuar hapësire për keqpërdorim.

Zenel Shatri, LDK – për këtë stacion u bë shumë bujë e madhe prej mandatit të kaluar jemi duke folur, me vëmendje e shikova raportin që e ka dhënë drejtori ekzekutiv ka përshkruar vetëm punët që i ka krye e faktikisht asgjë nuk është kryere ne shpeshherë kemi ndarë edhe mjete që ajo kompani të zhvillohet, Stacioni i Autobusëve është një vend shumë me rendësi që aj të funksionoj. Për mënyrën se si të funksionoj kjo ndërmarrje duhet që anëtarët e bordit menaxhuës dhe grupi i aksionarëve të gjithë punëtorët ta bëjnë një strategji se si të dilet nga kjo gjendje.

Mirushe Sadikaj, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, thotë se vetë ky raport tregon mos punën e të gjithë punëtorëve të cilët punojnë në atë ndërmarrje që nga qershori i vitit të kaluar e deri me tani nuk janë pagur taksat, shpenzimet janë rritur për me shumë se 26 mijë euro dhe shifet se për kundër tarifave, realizimi nuk është rritur realizim kemi vetëm në muajin prill menjëherë ka ulje të realizimit apo të inkasimit të operatorët të cilët operojnë të hynë në Stacionin e Autobusëve dhe kjo është mos punë e të gjithëve dhe e organeve të Komunës që duhet të punon me realizimin ose rritjen e inkasimit, në raport thuhet që një pastruese e ka lëshuar punën për mos epjen e pagës, ndërsa të njëjtën pagë që e ka marr pastruesi e ka marr punëtori tjetër plus e ka marrë këtë rrogë në bazë të mëditjes që ka punuar.

Agron Avdijaj, VV – thotë se nga ajo që vërehet nga raporti nuk dua ta amnistojë nga ana e drejtorit atje, bënë analizën e realizimit për të hyrat e që në 2017 del pak mbi mbi. Është shumë urgjente të krijohet një strategji me e mirëfillte se si do të funksionoj kjo, është një ikje e përgjegjës nga të dy anët drejtori thotë se e ka bërë kërkesën dhe nuk e ka shqyrtuar kërkesën, Komuna nuk ka inspektor e hjekë përgjegjës, ndërsa në anën tjetër kërkojmë përgjegjësi me qenë të punësuar aty dhe që nuk kanë marrë paga hiq ndërsa neve një mëditje me na u mohuar këtu secili nga ne ankohe mi, ndërsa ajo gjendje

nëse shkon kështu vetëm ka me shkua keq e me keqe , tek inspektoriati me pak vullnet politik mund mundë të përmirësohen shumë, gjobat që janë shqiptuar nuk e di a kanë funksionuar, inspektori me dal nga here në teren dhe me i ndaluar të gjithë autobusët e me jua kërkuar faturën e peronit duhet të ketë bashkëpunim për ti kryere punët dhe jo tu ikim përgjegjëse.

Naim Imeraj, AAK – thotë se po vazhdon me u imponu si temë e nxehtë çështja e Stacionit të Autobusëve, si Kuvend i Komunës i kemi dhënë ndiem pastaj i kemi ndjekur hapat ligjor që pësojmë si të tillë, qëllimi ka qenë që në fushën e komunikacionit ti epet si të tillë qytetarit që ta gëzoj një shërbim i cili ekziston po thuajse gjithëkudo, kemi pasur ratat të udhëtojmë dhe të shikojmë se si funksionojnë Stacionet e Autobusëve, esenciale është dhenja e shërbimit po esenciale në atë raport ku shikohen numrat që ata që janë të thirrur me ligj me i shfrytëzuar ato shërbime jo vetëm qytetarët si shërbime të transportit po operatorët ekonomik të licencuar për mbajtjen e viave të kryejnë obligimet e veta, mjafton me hi me e shikuar qoftë anën raporteve qoftë numerike raportimi. Nëse kemi dashur ti rehatojmë disa njerëz aty kemi bërë gabim se për shkak të atyre njerëzve. Ne kemi pasur pajtime ligjore me stafin stafi është në bazë të rregullave të cilët i përcakton ligji. Situata nuk është në pamje e trafikut në komunën e Istogut ne kemi rregullore të trafikut në nivel komunal e cila i përcakton gjërat saktë.

Mentor Vuthaj, kryeshef ekzekutiv i ndërmarrjes Stacioni i Autobusëve - bënë prezantimin dhe sqarimin e Raportit të punës së Ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve “ për periudhën 1 vjeçare , Prill 2017-Mars 2018.

Zenel Shatri, LDK – pyete a kërkon dikush nga stacioni i autobusëve dëshmi që është duke u mbajtur via në mënyre që me ju dhënë leja e mbajtjes së asaj vie a merret për çdo vit apo si.

Mentor Vuthaj – kjo leje merret për çdo 3 vite, rendin e udhëtimit e jep ministria e transportit.

Haki Podrimaj, LDK – pyete ju a raportoni çdo tre muaj në Ministri ? kush e ka licencuar Stacionin , inspektorati komunal ndihmojnë por ministria është kompetente.

Mentor Vuthaj – jo nuk raportoj, ministria e ka licencuar Stacionin, i kamë imellat kamë qenë në ministri të infrastrukturës me shumë se tri herë, edhe si pasoj e kësaj ma kanë dërguar auditorin ndërkombëtar, dhe jam audituar prej tyre. Dhe me kanë thanë me ketë edhe 3 vjetë je në bankete.

Zenel Shatri, LDK – ju duhet të raportoni para ministrisë për mbajtjen e linjave, komuna nuk i ka të gjitha kompetencat ka kompetenca e ministria e Infrastruktues.

Arben Kabashi, PDK – thotë që edhe kryeshefi e ceku që kompania është e falimentuar në total, jepe tri propozime të shkarkohet kompletë me urgjencë stafi ekzekutues kryeshefi, bordi komplet. E dyta të ndryshohet statusi i pronarit, aksionarit kryesor ti jepet me koncesion ose partneritet publiko privat dhe e treta të formohet një ekip profesional ose të vazhdohet me zbatimin e rregullores se punës ose një planifikim

për te ardhmen. Borxhet po mesin dhe me zbatua ata te paren na po bimë ne kundërshtim me ata para dy vjete kur e kem themelu kompaninë se na kem marrë vendim jo me financim vit pas viti, po me i dhen përkrahje herë pas here. Jemi një situatë të pa lakmueshme.

Ata çka e ceke ne fillim është e falimentime e ajo qe je thirr në podrum qe e ke marrë tasterenë, ajo o përgjegjësi e jotja, pse përdori sa e ke besu edhe e ke pranua një detyrë të tille detyrë e jotja edhe me gjet mundësinë me na pru neve materiale, nuk është përgjegjësi e jona.

Agron Avdijaj, VV – thotë sipas kësaj qe po vërehet na qysh në fillim koka planifikuar me dështuar. Për ata qysh e tha kryeshefi ekzekutiv atje që atëherë ka paralajmërua që me këtë inkasim nuk ka mundësi me u mbulua te hyrat, atëherë kuvendi e paska marrë përsipër qe te ndahet vazhdimisht buxhet i caktuar. Në anën tjetër këtu e kemi edhe një te dhanë qe thotë: nuk dihet sa operator nder urban operojnë në komunën e Istogut qe do te thotë na nuk nëmi te saktë se sa kompani janë te licencuara qe me e bë planifikimin. Atëherë lind pyetja qysh kemi me e bë planifikimin në rast se si kemi këto informata. Për ata që kanë me e bë qet strategji është shumë mire me u pajis me këto detaje edhe me e nxër nifar pike të rentabilitetit, edhe caktimi i kostos bahet me qëllimin me ule, me jua lehtsu kompanive ndoshta pa e analiza mirë, duhet me këqyr me analizua edhe niher. Përderisa një kompani e cila mundet me kane e Istogut këtu heziton me pagua një euro ose dy euro sa është 1me 3 ndërsa në Pejë e paguan dy e gjysmë edhe tre ndërsa ne Prishtine e pagunë edhe ma shtrenjte e njëjta kompani këtu se pagunë atje e pagunë. Këtu nuk është ne pyetje te kompania, institucioni dhe ekzekutivi i cili ka përgjegjësi për me menaxhua si duhet këtë situatë. Prandaj unë konsideroj qe kjo situatë donë vullnet politik. Nuk po dua me shfajësu disa përgjegjësi nëse them kush o fajtori këtu i kisha listat komplet qeto institucione që janë përgjegjëse e dikundë qaty jeni edhe ju kryeshef sepse disa përgjegjësi mundni. Përshembull te kjo ministria përpara kemi konsideruar si shpijullak me raportua se ka vinë, edhe vet exoficio e din cila kompani s’po hi një imell qaty gjatë këtij muajt këto kompani jon hi, qeto s jon hi.

Enver Rugova, drejtor i shërbimeve Publike – pasi kamë qenë edhe njëri nder aksioneret e mandatit të kaluar për këtë ndërmarrje, këtu jemi zgjedhur nga Kuvendi ish drejtori i shërbimeve publike unë nga LDK dhe Arif Elshani nga opozita Arben pikërisht ti e ke zgjedhur e ke propozuar. Si grup i aksionarëve janë takuar disa herë nuk është e lehtë me krijuar kompani lokale përmes ligjeve dhe rregullave se jemi shtet i letrave Kuvendi komunal i ka ndarë mjetet bashkërisht edhe për licencim që është dashur të plotësohen disa kushte po edhe për funksionalizim që nuk ka qenë në aspekt ndërtimor teknik . e kemi formuar bordin e Stacionit të Autobusëve konform ligjit dhe rregullave që i parasheh ligji bordi është formuar si komision i aksionareve e kemi mbikëqyrur dhe e kemi mbarëvajtje rregullsinë ka pasur të interesuar por jo sa kemi pritur ne i kemi përzgjedhur ata të cilët na ka marr menja që mund ta dhënë kontributin me shumë jemi marr vesh që në atë bord të jetë edhe dikush nga opozita dhe fatmirësisht aj nga opozita e ka japë kontributin e vetë z. Hivzi Sylaj jam i kënaqur me punën e tij.

Lut që edhe një shancë të ja japim Stacionit të Autobusëve.

Do të këtë Strategji e cila do të behet nga bordi i aksionareve për daljen nga kjo gjendje e tanishme dhe do ta sjellim në mbledhjen e ardhshme.

Kuvendi komunal më 19 vota për, dhe 3 abstenime vendosi:
Që Raporti të punës së Ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve “
për periudhën 1 vjeçare , Prill 2017-Mars 2018
Miraton me shumicë votash.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e nëntë të rendit të ditës, Marrja e Vendimit për themelimin e inkubatort të biznesit

Nënkryetar i Komunës – prezanton dhe sqaron Vendimit për themelimin e inkubatort të biznesit.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim:

Kuvendi komunal më 19 vota për vendosi:
Që Vendimit për themelimin e inkubatort të biznesit.
Miraton me shumicë votash.

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e dhjetëtë rendit të ditës, Rialokiimi i mjeteve nga nënprogrami buxhetor të Arsimit shkollës së mesmes në nënprogramin buxhetor të programit të arsimit fillor, Kuvendi duhet të marr një vendim për këtë alokim

Nënkryetari i Komunës – prezanton dhe sqaron Rialokiimi i mjeteve nga nënprogrami buxhetor të Arsimit shkollës së mesmes në nënprogramin buxhetor të programit të arsimit fillor, Kuvendi duhet të marr një vendim për këtë alokim.

Ajshe Metaj, PDK – pyet, pse ka ndodhur kjo tepricë për arsimimin e mesëm ndërsa ka mungesa në nendegat e arsimit Fillorë, pse ka ndodhur kjo? Sa gjera mbeten të pa realizuara në qoftë se tërhiqet kjo pjesë e buxhetit e arsimit të mesëm e kalon në fillor. Cilat janë pasojat?

Nënkryetari i Komunës – përgjigjet qe as një pasoj nuk do të ketë, kurë është bërë llogaritja e parasë është konstatuar që ka tepricë të mjeteve për paga në kategorinë e pagave. Kjo ka ardhur si rrjedhojë se shumica dalin në pushime të leonis dhe duhet të zëvendësohen dhe personi që angazhohet duhet të marr pagën e plotë.

Kuvendi komunal unanimish vendosi:

Që Rialokimi i mjeteve nga nënprogrami buxhetor të Arsimit shkollës së mesmes në nënprogramin buxhetor të programit të arsimit fillor, Kuvendi duhet të marr një vendim për këtë alokim.

Miraton unanim.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:10.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

